



BULETINI

JANAR 2022

Komuna e Lipjanit

KOMUNA E LIPJANIT – ZYRA PËR INFORMIM

☎ 0 800 14 000 / 038 200 41 508

✉ infokomuna.lipjan@rks-gov.net

KK-LIPJAN
SCAN



Rr.Shqipëria nr: 28, 14000 Lipjan, Kosovë

U mbajt seanca e tretë e Kuvendit Komunal në Lipjan

Kuvendi Komunal i Lipjanit sot nën udhëheqjen e Kryesuesit Daut Azemi ka zhvilluar punimet e mbledhjes së tretë, mbledhje kjo në të cilën u aprovuan pikat e rendit të ditës të cilat u propozuan për shqyrtim gjatë kësaj seance.

Fillimisht Kryetari Imri Ahmeti ka dhënë sqarime në pyetjet dhe temat e ngritura nga anëtarët e Kuvendit Komunal.

Është prezantuar raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar – Dhjetor 2021 duke u bazuar në FB të datës 17.01.2022, është dhënë informatë mbi pandeminë nga Drejtorati DSHPS-së, është miratuar propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSBB, propozim vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete, propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa, propozim vendim për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, propozim vendim për themelimin e Komitetit për Arsim, propozim vendim për themelimin e Komitetit për Kulturë rini dhe Sport. Po ashtu, gjatë seancës kanë dhënë betimin edhe dy antarët e rinjë të Kuvendit, Gentiana Hoxhaj dhe Venhar Agushi.



Nderohet me homazhe heroit Ismail Luma-Altini

Me rastin e 23 vjetorit të rënies së heroit Ismail Luma-Altini, Nënkryetari Diamant Bytyqi me bashkëpunëtor kanë bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë lapidarit të heroit në shkollën Ismail Luma.

Lavdi të gjithë dëshmorëve dhe martirëve!





Vaksinohu!

#Bashkëiadalim